<sup>41</sup> Interview with Shemsi Veseli, member of Municipal Assembly of Prishtina, 04.05.2011

<sup>42</sup> *Regulation for Transparency, Article 5 (5.1-5.2), Municipality of Prishtina*, <http://kk.rks-gov.net/prishtina/>

<sup>43</sup> *Law on Local Self Governance*, <http://www.assembly-kosova.org/>

<sup>44</sup> [www.inpo-ks.org](http://www.inpo-ks.org)

<sup>45</sup> Article 'INPO-ja nuk e fal mungesën e deritashme të transparencës së KPF-së', Koha Ditore, 24.06.2011

<sup>46</sup> Interview with Office for Assembly Services, Prishtina Municipality, 03.05.2010

---

INPO has been permitted to participate in these meetings only after they have insisted for more than a year, through many contacts and official complaints to the Ministry of Local Governance and Ombudsperson. Their Executive Director leaves a part of responsibility on this also to the Ministry of Administration of Local Governance (MALG), which should have reacted earlier, since it has a higher mandate on municipalities. This indicates that this ministry is not doing its best in monitoring the implementation of laws at the local level.<sup>47</sup>

Another case which demonstrates the lack of will of the Municipality of Prishtina to cooperate and involve civil society is the process of amending the Municipal Statute, which in a great extent leaves civil society outside Consultative Committees. According to HANDIKOS, during the previous mandate, this organisation had five representatives participating in five different committees: public services, health, education, sport and spatial planning. According to the new Statute and regulations, members of these committees can be only members of the Municipal Assembly, with the reason that there is not a sufficient budget for other representatives.<sup>48</sup>

These are only some of the cases which make this municipality be considered as a closed one. The level of knowledge on the role of civil society remains very low in this municipality, the same as in many other ones. There are still municipal officers who cannot differentiate civil society organisations with public institutions or international missions. When asking a municipal officer which domestic NGOs participate in the meetings of the Committee on Communities<sup>49</sup>, the response was: OSCE, KFOR, Ministry of Return and Communities..!

In regards to informing the public or civil society, not much can be said. Almost all municipalities have their Municipal Offices for Public Communication, which are responsible to communicate to the public on municipal policies and activities. The functions of an adequate administrative structure might be conducted from one officer with combined functions, or a number of officers on one function.<sup>50</sup>

In the case of the Prishtina Municipality, the Office for Public Relations is not in fact serving the public, according to one of the members of the Municipal Assembly, which declares *'this office is serving only to leading structures in power, but not others. In reality, it is completely closed for others. The few public meetings that we organise are only for the sake of holding them, while the information and documents are published to the official Web site of the Municipality too late'*<sup>51</sup>.

Similarly, this municipality does not have any office or officer dealing with civil society, and it does not have any database of civil society organisations. The invitations are being sent only to some NGOs which they have heard of, although many times there are no invitations at all. One officer of this municipality says *'we do not deal that much with NGOs. They are not active and they do not come when we invite them.'*<sup>52</sup>

---

<sup>47</sup> Avni Bytyci, INPO- speech at 'Experts roundtable on best practices on citizens', organised by KCSF, 12.05.2011

<sup>48</sup> Interview with Mehreme Llumica, HANDIKOS, 13.04.2011

<sup>49</sup> This committee was considered by this officer as the committee where NGOs have more interest

<sup>50</sup> Regulation on the Public Communication Service of the Government, Article 14, viewed on 03.05.2011 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE\\_03\\_2011\\_PER\\_SHERBIMIN\\_E\\_KOMUNIKIMIT\\_OEVERITAR\\_ME\\_PUBLIKUN.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_03_2011_PER_SHERBIMIN_E_KOMUNIKIMIT_OEVERITAR_ME_PUBLIKUN.pdf), viewed on 03.05.2011

<sup>51</sup> Interview with Shemsi Veseli, member of Municipal Assembly of Prishtina, 04.05.2011

<sup>52</sup> Interview with Office for the Assembly Services, Prishtina Municipality, 03.05.2010

---

Civil society representatives say that even when they are invited by the municipality, those debates or meetings are only formal, without any serious or consistent approach. She takes as an example a non-formal debate organised by the Municipality of Prishtina, aiming to foster cooperation with civil society. According to her, the Municipality invited in this debate only some unknown and non-active NGOs, while the credible and active NGOs were not invited at all. She thinks that this happens because there are other interests in there, and the debate is only to tick the box<sup>53</sup>.

However, there are some organisations which have contacts and cooperation with municipal authorities, although not on a regular basis. This is confirmed also by the Executive Director of HANDKOS, who says that *'from time to time we have contacts and meetings with leading structures of the Municipality of Prishtina. However, we had more contacts previously than now.'*<sup>54</sup>

This process should also be advanced from civil society. Currently, none of the parties are playing their role properly. Civil society is not very active, as one municipal officer says *'INPO is the only NGO monitoring the work of Municipality of Prishtina. I do not have information on any other NGO active in this direction'*<sup>55</sup>.

This is confirmed also by a member of the Municipal Assembly, which says that *'during previous years there have been more active NGOs with their projects on monitoring the work of municipal authorities'*. He adds that *'one of the reasons for this is also because the municipality itself does not offer any possibility for cooperation. Both parties need to reflect more and work together more.'*<sup>56</sup>

---

<sup>53</sup> Interview with Naime Sherifaj- Center for protection of woman and children (QMGF), 07.04.2011

<sup>54</sup> Interview with Afrim Maliqi, HANDIKOS, 21.07.2011

<sup>55</sup> Interview with Office for Assembly Services, Prishtina Municipality, 03.05.2010

<sup>56</sup> Interview with Shemsi Veseli, member of Municipal Assembly of Prishtina, 04.05.2011

---

## IV. Conclusions and Recommendations

In a democratic society, public institutions are only one of the actors which contribute to improving the 'common good'. Other sectors have their say on the benefit of society too. Citizens, as the ultimate holders of power, have to find their alternative ways to be heard and contribute to the overall development of the community, municipality and state. As the most organised form of citizen's initiatives, civil society is a key element in ensuring that a democracy is functioning and different groups and stakeholders are heard when a decision is taken. Choosing a democratic system of governance, Kosovo has stipulated different levels of constitutional and legal provisions in order to ensure that this is an obligation for all who have a stake in this system.

While exploring how Kosovo institutions face this obligation through establishing respective institutions and mechanisms for making these rights become reality, one finds out that it has moved 'beyond zero'. A number of institutions are in place and positive steps have been taken since the initial period of establishing institutions in Kosovo. As a starting point towards cooperation between state and civil society, this could be considered satisfactory. However, it is almost a decade now that these initial steps were not followed further and very limited improvement has been seen, remaining still just 'beyond zero'.

Moving beyond this point is difficult, but necessary. Public authorities and civil society both have their roles and responsibilities and each should respect them. Acknowledging respective roles is the basic precondition if aiming to start a genuine dialogue and cooperation for the benefit of the ones that we all represent, citizens. In addition to this, a new mindset from both sides should be introduced. This is true in particular when it comes to public authorities, who should not consider civil society as 'political opponents' but take their critiques as a contribution towards improving its services and governance in general.

At the other side, civil society should be more active in monitoring the work of public authorities and providing respective alternatives for the issues of importance, in particular at the local level. As we can note from this report, while many distinguished civil society organisations are focused on major issues on the central level, the local level is many times left aside. The case of the Peja Municipality gives a great example that when there is an active civil society, the public authorities cannot resist from benefiting from their information and expertise, and civil society involvement is the natural thing to happen.

When considering whether specific institutions for cooperation with civil society are necessary for such a cooperation to happen, Peja Municipality gives as again another argument: although no specific body or institution exists, the cooperation is very successful at all levels. This is true when public authorities understand the principles of democracy and citizenship and the benefits from cooperating with civil society.

What if public authorities are closed? Would the existence of specific institutions make the cooperation obligatory, despite the lack of political will to do this? This is an open-ended question and no single answer is true. However, the authors of this report – analysing the specific cases in Kosovo

---

and exploring a number of interesting cases from countries similar to Kosovo – concluded that formalizing the cooperation and specifying which institution is responsible to handle this cooperation is one of the first steps, although not the only one towards reaching a common understanding of each others' obligations and setting realistic expectations from such a cooperation. Such formal agreements and institutions would not limit the cooperation only when there is a good political will, but it would become an obligation for all public authorities. When the necessary mechanisms are in place, it is up to civil society if is active enough to use them.

---

## Recommendations

### For Government (central and local level)

- To increase the understanding of the role of civil society within the public administration;
- To create a comprehensive governmental policy on cooperation with civil society;
- To restructure the institutions responsible for cooperation with civil society; according to the governmental policy on cooperation with civil society;
- To review the mandate of the Office of Good Governance in order to balance the capacities with its mandate;
- To reduce the mandate of the NGO Department in NGO registration only;
- To amend its regulations on Consultative Committees in Prishtina Municipality in order to involve members from civil society, according to the legal provisions on this issue;
- To open all the meetings of the Prishtina Municipal Assembly and its Committees or issue reasoned decisions when closed meetings are required;
- To explore possibilities of formalizing the cooperation between the Municipality of Peja and civil society, in order to ensure a long-term cooperation, not dependent on the will of the political party in power;
- To appoint civil society liaison officers within Municipalities throughout Kosovo.

### For Civil Society

- To increase the understanding of the role and obligations of specific institutions on the central and local level;
- To increase pressure on the Office for Good Governance for advancing its work from reporting to follow-up actions based on the produced reports;
- To increase its activity at the local level, through monitoring municipalities and offering contributions in municipal policy-making and service provision;
- To assist the government in increasing the capacities of its administration in regards to cooperating with civil society;
- To exchange information on good practices in different municipalities, in order to multiply positive examples in similar cases;
- To propose alternatives and solutions to public policy making;
- To respond positively to requests and information coming from government;
- To get organized and establish sectorial networks so that it responds thematically to government cooperation.

---

## Përtej Zeros

Strukturat institucionale për bashkëpunim me shoqërinë civile

Kosovë  
Gusht, 2011

Shënim: Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e projektit Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

---



---

## Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| Hyrje nga TACSO .....  | 24 |
| I. Hyrje.....  | 25 |
| II. Strukturat institucionale për bashkëpunim me shoqërinë civile në nivelin qendror ..... | 27 |
| a. Zyra për Qeverisje të Mirë.....   | 27 |
| b. Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ .....                                 | 30 |
| III. Mekanizmat institucional për bashkëpunim me shoqërin civile në nivelin lokal .....    | 35 |
| a. Të bashkuar në rrugën 'Përtej zeros' .....  | 35 |
| b. Të ndarë në rrugën 'Përtej zeros' .....   | 37 |
| IV. Konkluzione dhe Rekomandime.....   | 40 |

---

## Hyrje nga TACSO

Projekti Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) qëllim të përgjithshëm ka fuqizimin e shoqërisë civile brenda një demokracie pjesëmarrëse, të stimulojë një ambient dhe kulturë miqësore të shoqërisë civile, si dhe të sfidojë kapacitetet e përgjithshme dhe përgjegjësinë e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) brenda përfituesve të vendeve të IPA-së (Ballkanit perëndimor dhe Turqisë), të garantojë kualitetin e shërbimeve të OSHC-ve dhe rolin e qëndrueshëm të OSHC-ve në procese demokratike. Objektivat kryesore të projektit janë: rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve dhe veprimeve të OSHC-ve dhe të përmirësojë rolin e tyre demokratik.

Që nga fundi i konfliktit, pas vitit 1999, Kosova nën UNSCR 1244/99 (më tutje Kosovë) po kalon një periudhë tranzicioni të hartimit të legjislacionit dhe themelimit të institucioneve të nevojshme për një vend të ri demokratik. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që të ketë mekanizma ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë bashkëpunim me shoqërinë civile si një parakusht për proceset e integritit.

TACSO Kosovë, në partneritet me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile, ka ndërmarrë iniciativën për përgatitjen e këtij publikimi që analizon institucionet ekzistuese në administratën publike për bashkëpunim me shoqërinë civile në Kosovë. Në përgatitjen e këtij studimi, ne kemi zhvilluar konsultime të gjera me shoqërinë civile dhe organet qeveritare në Kosovë me qëllim që së bashku të diskutojmë këtë çështje dhe të përpiqemi të gjejmë një pikë të përbashkët me të cilën të gjithë pajohemi dhe të zhvillojmë më tej idetë e reja që sigurojnë dialog cilësor me shoqërinë civile në Kosovë.

Ky publikim ofron informata konkrete nga praktika se si funksionon dialogu midis qeverisë dhe shoqërisë civile, cilat janë institucionet përgjegjëse për këtë dialog dhe çfarë duhet bërë për të avansuar këtë dialog. Qëllimi i këtij publikimi është të ofrojë rekomandime konkrete për qeverinë e Kosovës, shoqërinë civile dhe të shërbejë si një mjet për të lehtësuar proceset e ardhshme si dhe mbështetjen ndërkombëtare për këtë sektor.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, Komisioni Evropian (KE) vazhdimisht nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit midis qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe shoqërisë civile në dokumentet zyrtare dhe komunikatat<sup>57</sup> që nxjerr ky institucion si parakusht që mundëson një proces cilësor të zgjerimit. Më tej, KE u bën thirrje qeverive të BP për të avansuar dialogun qytetar në hartimin dhe zbatimin e politikave qeveritare dhe shfrytëzim më të mirë të kapaciteteve të shoqërisë civile.

Ardita Metaj-Dika  
Këshilltare vendore  
TACSO –Kosovë  
Prishtinë, gusht 2011

---

<sup>57</sup> [Commission Communications](#) on the “Western Balkans” (2006) and on “Civil Society Dialogue in Candidate Countries” (2005)& [Enlargement Strategy Papers](#)

---

## I. Hyrje

Ky raport është përgaditur në kuadër të projektit 'Asistencë teknike për organizatat e shoqërisë civile' (TACSO) të mbështetur nga Bashkimi Europian<sup>58</sup>. Hulumtimi dhe përpilimi i këtij raporti është bërë gjatë periudhës kohore Prill – Qershor 2011. Raporti është përpiluar duke u bazuar në të dhënat primare të dala nga intervistat e thella me përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe përfaqësues të shoqërisë civile, respektivisht nga organizatat e shoqërisë civile, konsultimet/diskutimet publike me organizata të shoqërisë civile të organizuara nga TACSO për qëllimet e këtij studimi si dhe të dhënat sekondare të gjetura në literaturë, raporte, strategji, studime relevante ekzistuese. Gjithashtu, raporti është plotësuar me të dhënat nga ligjet, rregulloret dhe vendimet të cilat janë të aplikueshme në Kosovë.

Kushtetuta e Kosovës inkurajon përfshirjen e qytetarëve (dhe shoqërisë civile) në punën e autoriteteve publike, ndërsa korniza aktuale ligjore përmban një numër dispozitash që e mundësojnë këtë të drejtë themelore. Institucionet publike përgjegjëse për të siguruar se të drejtat kushtetuese dhe ligjore po zbatohen, janë të obliguara të sigurojnë se janë themeluar dhe mandatuar organet përkatëse për të lehtësuar procesin. A janë themeluar organet përkatëse, dhe mandati i këtyre organeve a është në përputhje me dispozitat ligjore për këtë çështje? A po zbatohet mandati i tyre? Cilat janë sfidat e të dy palëve për t'a ushtruar këtë të drejtë? Cilat janë çështjet kryesore që duhet të adresohen për të siguruar një bashkëpunim të mirëfilltë në mes të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile? Këto janë disa nga pyetjet kryesore që ky raport synon për të cilat ky raport synon të ofrojë përgjigje.

Më konkretisht, raporti ka për qëllim të analizojë stukturat ekzistuese institucionale të Qeverisë së Kosovës në nivelin qendror dhe lokal në lidhje me bashkëpunimin me shoqërinë civile; mandatin e organeve ekzistuese, zbatimin e mandatit ekzistues si dhe sfidat kryesore dhe mundësitë që hasin gjatë punës gjersa punojnë së bashku. Studimi është fokusuar në analizimin e organeve ekzistuese për bashkëpunim me shoqërinë civile, siç janë: Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ-të në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa në nivelin lokal, Zyrat për Komunikim si dhe Komitetet Konsultative në kuadër të kuvendeve komunale.

Qeveria qendrore dhe ajo lokale bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile në momente dhe nivele të ndryshme. Qeveria e Kosovës dhe kuvendet komunale kanë themeluar organe të ndryshme të cilat janë të mandatuar për ta lehtësuar shfrytëzimin e kësaj të drejte nga qytetarët, respektivisht për ta mundësuar një bashkëpunim më të strukturuar të autoriteteve publike me shoqërinë civile. Shpesh herë ky bashkëpunim vlerësohet pozitivisht nga të dyja palët, herë tjera cilësohet si i pamjaftueshëm, ad-hoc apo mungon në tërësi.

Që nga viti 1999 e tutje, bashkëpunimi i autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile ka qenë mjaft kompleks, duke marrë parasysh praninë e madhe ndërkombëtare e cila ka ndikuar shumë në zhvillimin e marrëdhënieve në mes të këtyre dy palëve, si dhe mungesën e traditës së dy sektorëve

---

<sup>58</sup> [http://www.tacso.org/Default.aspx?template\\_id=69&langTag=en-US&pageIndex=1](http://www.tacso.org/Default.aspx?template_id=69&langTag=en-US&pageIndex=1), shiquar me 26.05.2011

---

sa i përket bashkëpunimit të ndërsjellë. Megjithatë, tani tri vite pas pavarësisë së Kosovës, bashkëpunimi në mes të këtyre dy palëve, po merr një dimension tjetër.<sup>59</sup> Secila palë, si autoritetet publike poashtu organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) janë në fazën e njohjes reciproke, rritjes, zhvillimit dhe gjetjes së mënyrave të duhura të bashkëpunimit.

Megjithatë, ende i gjithë bashkëpunimi dhe komunikimi pothujase zhvillohet dhe ndërtohet mbi bazën e një vullneti të mirë ose jo të mirë. Takimet me shoqërinë civile, respektivisht më shumë të natyrës ad-hoc, shpesh vetëm formalisht, sa për të thënë se po bashkëpunohet dhe sa për të plotësuar kërkesat e nevojshme dhe të vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Deri më tani, ende nuk ka asnjë formë institucionale apo strategji bashkëpunimin të autoriteteve publike me OSHC-të.

Në vitin 2007, ka pasur një nismë për të krijuar një partneritet formal në mes të Platformës CIVIKOS, (një platformë e OJQ-ve kosovare) dhe Qeverisë së Kosovës, e cila nuk arriti të funksionalizohet deri më sot, edhe pse platforma është ringjallur kohëve të fundit dhe është në proces të rifillimit të tërë procesit/ciklit. Anëtarët e kësaj platforme janë duke hartuar një strategji për bashkëpunim, e cila pastaj do t'i dorëzohet Qeverisë për diskutim dhe miratim.<sup>60</sup>

Në anën tjetër, ka raste të bashkëpunimit me organizata individuale në fusha të caktuara (kryesisht në shërbime sociale), e në disa raste ka edhe memorandume bashkëpunimi në mes të minsitrive dhe OJQ-ve përkatëse të sektorit (siç është rasti i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me organizata mejdisore apo Ministrisë së Punëve të Brendshme me organizata që ofrojnë shërbime sociale). Por, prap kjo është e pamjaftueshme dhe nuk reflekton pasqyrën e përgjithshme të bashkëpunimit në mes të dy Qeverisë dhe sektorit jo-profitabil.

Andaj, qëllimi i këtij raporti është që të ofrojë të dhëna konkrete nga praktika e përditshme , respektivisht nga funksionimi i këtyre organeve si dhe të ofrojë rekomandime që do të kontribuojnë në përmirësimin e performancës si të autoriteteve publike poashtu edhe të shoqërisë civile. Rekomandimet e dala nga ky raport do ti shërbejnë Qeverisë rreth strukturave insitucionale që mirren me bashkëpunimin me shoqërinë civile, si dhe do të ndihmojnë shoqërinë civile se si duhet ti qasen më mirë çështjes së bashkëpunimit në raport me institucionet përgjegjëse për këtë bashkëpunim, në nivel qendror apo lokal.

---

<sup>59</sup> Dita e Pavarësisë së Kosovës; 17 shkurt 2008

<sup>60</sup> Intervistë me Dren Puka- Sekretariati i Plaformës CiviKos, 20.07.2011

---

## II. Strukturat institucionale për bashkëpunim me shoqërinë civile në nivelqendror

Aktualisht në nivel qendror, ka dy institucione të cilat do të duhej të nxisnin pjesëmarrjen qytetare dhe të bashkëpunonin me shoqërinë civile, respektivisht OShC-të. Këto institucione janë: Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ si dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të cilat do të elaborohen në vijim.

### a. Zyra për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit

#### Mandati

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) është themeluar me Rregulloren Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit, e mëpastaj mandati dhe detyrat e kësaj zyreje u ri-konfirmuan edhe me rregulloret tjera përkatëse.<sup>61</sup> Kjo zyrë është e vendosur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM), dhe është funksionale që nga vitit 2002, ka gjithësejt 7 punonjës.

ZQM-së ka për mandat të bëjë mbikëqyrjen dhe këshillimin e punës së Qeverisë në sferat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta. Më konkretisht, sipas këtij mandati ZQM-ja krijon politika të veprimit dhe nxjerr urdhëresa, shqyrton projekt-rregulloret qeveritare, këshillon dhe jep rekomandime për Kryeministrin dhe ministrinë, këshillohet me publikun dhe krijon organe këshilldhënëse, promovon dhe ngrit vetëdijen mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, qeverisjes transparente, barazisë gjinore, mundësive të barabarta, kundër mashtrimit dhe korrupsionit dhe parimeve tjera të qeverisjes së mirë, demokracisë, transparencës si dhe inkurajon pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje.<sup>62</sup>

#### Funksionaliteti

Sipas këtij mandati ZQM-ja mbetet organi i vetëm i Qeverisë së Kosovës në nivel qendror përgjegjës për pjesëmarrjen qytetare në qeverisje, respektivisht përfshirjen e shoqërisë civile në punën e Qeverisë. Edhe në dokumentet e publikuara nga kjo zyrë vazhdimisht theksohet nevoja për inkurajimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, si dhe kanalizimin e ekspertizës ekzistuese të këtyre organizatave.

Kështu, në Raportin mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (Janar 2010 - Dhjetor 2010) të hartuar nga ZQM-ja, thuhet se *‘Qeveria duhet që të inkurajoj dhe të mbështesë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, duke pas parasysh dobritë e ekspertizës që ka zhvilluar shoqëria civile dhe për t’u siguruar që projektet e tyre të përputhen me objektivat e Strategjisë për të Drejtat e Njeriut’.*

---

<sup>61</sup> Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/15 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës

<sup>62</sup> Trendelinë Dreshaj, ZQM, 20.07.2011

---

Këtë e thotë edhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, nën mbikëqyrjen e të cilit është edhe ZQM-ja, i cili shprehet se *'ne jemi të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunim, por edhe shoqëria civile duhet të jetë më proaktive dhe më konstruktive. Të ofroj edhe alternativa, jo veqse kritika'*.<sup>63</sup>

Megjithatë, realisht pak bëhet në këtë drejtim. Përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile theksojnë se deri më tani ZQM-ja nuk ka përmbushur si duhet mandatin e saj, dhe ka qenë e fokusuar kryesisht në raportimin e ngjarjeve/aktiviteteve që i kryejnë njësitë/ministritë përkatëse se sa që angazhohet për të monitoruar zbatimin e strategjive të hartuara, për të këshilluar ministritë në fushat përkatëse apo për të zhvilluar bashkëpunimin konkret me shoqërinë civile, respektivisht hartimin e dokumenteve të nevojshme për nxitjen e këtij bashkëpunimi. *'Shpesh edhe raportet që dalin nga ZQM-ja nuk korrespondojnë me objektivat e parapara në strategjitë/dokumentet përkatëse thotë një përfaqësues i organizatës Handikos'*.<sup>64</sup>

Tani për tani edhe takimet, konferencat apo tryezat e rrumbullakëta mbahen vetëm formalisht, pa ndonjë vazhdimësi dhe zbatim të rekomandimeve që dalin nga këto aktivitete. Ndodh shpesh, që ZQM-ja të mos u përgjigjet ftesave për të marrë pjesë në konferenca/punëtori apo në ngjarje tjera që organizohen nga OSHC-të. Realisht, kjo zyrë tani për tani shërben vetëm si zyrë për raportim mbi aktivitete të caktuara. Shumë përfaqësues të shoqërisë civile mendojnë se kjo ndodh për shkak të mandatit aktual të ZQM-së, i cili konsiderohet si mandat relativisht i gjërë dhe i pamundshëm të implementohet nga stafi aktual i kësaj zyreje, qoftë për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale si dhe numrit të vogël të të punësuarve në këtë zyrë.

Situatë e ngjashme është edhe me informatat që publikohen nga ZQM-ja, e që nuk janë në nivel të kënaqshëm. Një raport i ZQM-së thotë se *'Institucionet qendrore dhe ato lokale, duhet në Eeb-faqet e tyre ta publikojnë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës(2009-2011), si dhe të përgatisin programe informuese për të gjithë nëpunësit civilë, rreth objektivave të strategjisë dhe rolit që kanë në zbatimin e saj'*. Megjithatë, mjafton të shikohet vetëm një herë faqja zyrtare e kësaj zyreje, për të konstatuar se pothuajse pak informata të reja janë postuar në këtë faqe që nga viti 2009.<sup>65</sup>

### **Bashkëpunimi me shoqërinë civile**

Edhe pse deri më tani ZQM-ZKM-ja nuk ka ndonjë dokument/strategji për bashkëpunim me shoqërinë civile, të dhënat e kësaj zyreje flasin për një varg rastesh të bashkëpunimit sektorial. Sipas të dhënave zyrtare nga kjo zyrë<sup>66</sup> ( raporte të ndryshme, strategji/plane veprimi, raporte 6 mujore etj), deri më tani ZQM-ja ka bashkëpunuar me shoqërinë civile në hartimin e disa strategjive dhe planeve të veprimit sië janë: hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011; Strategjinë dhe Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013; Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptas 2009 – 2015; Plani i Veprimit të

---

<sup>63</sup> Intervistë me Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm, ZKM, 18.04.2011

<sup>64</sup> Intervistë me Afrim Maliqi, Handikos, 21.07.2011

<sup>65</sup> <http://www.humanrights-ks.org/>, shiqar me 25.07.2011

<sup>66</sup> Raporte/strategji/plane veprimi/raporte gjashtë mujore etj, të cilat janë analizuar nga autorët e këtij raporti

---

Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015; Planin Kombëtar të Veprimit për personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011; Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit 2009 – 2011; Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Reformën e Administratës Publike 2007 – 2012 dhe dokumente tjera përkatëse.<sup>67</sup>

Ky bashkëpunim dhe përfshirje është bërë kryesisht me organizatat, misioni i të cilave është i lidhur drejtpërdrejt me fushat që janë në kuadër të kësaj zyre (të drejtat e njeriut, barazi gjinore, aftësi të kufizuara etj). Disa nga organizatat me të cilat ka bashkëpunuar ZQM-ja janë: Doën Syndrome Kosova, me Handikap Kosova, me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve, me Shoqatën e të Verbërve dhe me të Parë të Dobësuar, me Fondacionin Together të Kosovës, Handikosit dhe tjera. Vlen të ceket se ZQM-ja ka bashkëpunim edhe me shumë organizata ndërkombëtare si: OSBE, UNICEF, Ambasada Italiane – Italian Cooperation, Komisioni Evropian, Zyra e Komesariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, EULEX, Ombudspersoni, UNIFEM etj. Këto organizata ofrojnë mbështetje financiare/teknike për këtë zyre.

Këto organizata poashtu janë përfshirë edhe në disa mekanizma ndërministror, komitete drejtuese, komisione dhe grupe punuese si në: Këshillin Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara; Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve; Komiteti Drejtues Ndërinstitucional për Zbatimin e Planit të Veprimit të Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Roma, Ashkali, dhe Egjiptas 2009- 2015 etj.

Një shembull i këtij bashkëpunimi është përfshirja e përfaqësuesve nga shoqëria civile, edhe në mekanizmin koordinues dhe monitorues (komiteti drejtues ndërinstitucional) për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Integrimin e komuniteteve RAE. Ky komitet ka gjithësej njëmbdhjetë (11) anëtarë, tetë (8) prej të cilëve janë përfaqësues nga organet qeveritare dhe ministrive përkatëse, dhe tre (3) janë përfaqësues të komunitetit të shoqërisë civile nga komuniteti RAE.

Përzgjedhja e tyre është bërë përmes konkursit të hapur, ku kanë aplikuar organizatat e interesuar sipas kriterëve të përcaktuara nga ZQM-ja. Ndërsa, përzgjedhja është bërë nga Komisioni Vlerësues, në kuadër të së cilit ka qenë pjesëmarrës edhe një përfaqësues i shoqërisë civile.<sup>68</sup> Vlen të ceket se Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), si përfaqësues i shoqërisë civile në këtë komision, është përfshirë në këtë komision për shkak se ka qenë mbështetësi kryesor gjatë gjithë procesit të hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit, njëjtë sikurse që është partner i Qeverisë në hartimin e një numri të strategjive dhe dokumenteve tjera.

Edhe pse raportet zyrtare paraqesin një bashkëpunim shumë pozitiv, shoqëria civile argumenton se këta mekanizma shpesh nuk kanë vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në aktivitetet e tyre. *'Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, i cili është themeluar në vitin 2006, aktualisht nuk është funksional. Ky është rezultat i punës së pamjaftueshme dhe jo-konstencës së aktiviteteve të ZQM-së',* thotë një nga OJQ-të e përfshira në këtë proces.<sup>69</sup>

---

<sup>67</sup> Trendeline Dreshaj, ZQM, 21.06.2011

<sup>68</sup> ZKM-ZQM, Raporti një vjeçar mbi Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së RK për integrimin e komuniteteve RAE 2009-2015, Raporti/Janar-Dhjetor, f.12

<sup>69</sup> Intervistë me Afrim Maliqi, Handikos, 21.07.2011

---

Kur bëhet fjalë për çështjen e përfaqësimit të shoqërisë civile, asnjë procedurë e përzgjedhjes nuk ka mundur të identifikohet nga autorët e këtij raporti, duke ngritur kështu shqetësime mbi mungesën e rregullave specifike se si dhe me cilat OShC duhet të bashkëpunoj kjo zyrë, në ndonjë proces specifik për të cilin janë përgjegjës. Mjaft shqetësuese mbetet edhe dyfishimi i çështjeve që trajtohen nga ZQM-ja dhe institucionet e tjera.

Ka shumë aktivistë të shoqërisë civile të cilët theksojnë nevojën e ristrukturimit dhe ridefinimit të mandatit të kësaj zyreje. Kjo veçanërisht vihet në dukje, kur mirret parasysh se tani janë krijuar organe të reja publike, konkretisht në fushat që mbulohen nga mandati i ZQM-së siq janë: Agjensia për Barazi Gjinore; Njësitë për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Ministrive, Agjensioni Kundër Korrupsionit, apo Zyra Për Çështje të Komuniteteve.

Kjo konfirmohet edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, i cili poashtu shprehet se *'mandati aktual i ZQM-së është deri në vitin 2013...Mëpastaj, mandati ndoshta do të duhet të ri-strukturohet apo të ndryshohet, varësisht nga rrethanat e reja të krijuara'*- duke shtuar poashtu se *'më shumë përkrahje duhet t'i jepet nxitjes së bashkëpunimit me shoqërinë civile'*.<sup>70</sup>

E fundit por jo më pak e rëndësishme, ZQM-ja është gjithashtu përgjegjëse për *'të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje'*,<sup>71</sup> që do të thotë se kjo zyrë është e obliguar të jetë aktive në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në përgjithësi, dhe jo të kufizohet vetëm në të drejtat e njeriut, minoritete dhe çështje gjinore. Megjithëse në këta sektorë ka qenë aktive deri në një nivel të caktuar, pjesëmarrja qytetare në përgjithësi duket të mos jetë trajtuar fare. E vendosur në Zyrën e Kryeministrit dhe përgjegjëse në nivel horizontal të Qeverisë, kjo zyrë duke mos zbatuar këtë pjesë të mandatit të saj shkakton një vakum të përgjithshëm të politikës qeveritare në drejtim të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në punën e qeverisë në përgjithësi.

## **b. Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ**

### **Mandati**

Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ (DRNOJQ), në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, administron politikat që lidhen me regjistrimin dhe bashkëpunim me OJQ. Ky departament fillimisht u themelua si zyrë në kuadër të UNMIK-ut<sup>72</sup>, për tu shëndruar më vonë në Departament, konkretisht në mars të vitit 2005. Aktualisht, Departamenti për OJQ, është i organizuar në dy divizione: Divizioni për Regjistrimin e OJQ-ve dhe Divizioni i Raportimit dhe Monitorimit.

Divizioni i regjistrimit të OJQ-ve merret me aplikimet e OJQ-ve për regjistrim, shqyrton kërkesat për regjistrim dhe kërkesat e OJQ-ve për statusin e përfuturit publik; ndërsa Divizioni për Raportimin dhe Monitorimin e OJQ-ve merret dhe shqyrton raportet vjetore dhe financiare, monitoron nëse OJQ-të respektojnë statutet e tyre si dhe bashkëpunon me institucione tjera të rëndësishme.

---

<sup>70</sup> Intervistë me Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm, ZKM, 18.04.2011

<sup>71</sup> Nga mandati zyrtar i ZQM-së

<sup>72</sup> UNMIK Rregullorja 1999/22, [http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re1999\\_22.htm](http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re1999_22.htm), shiquar me 8.07.2011



---

Më konkretisht, DRNOJQ-ja pranon dhe analizon kërkesat për regjistrim të OJQ-ve, shqyrton kërkesat për Status për Përfitim Publik, pranon dhe analizon raportet vjetore me pasqyra financiare të OJQ-ve, monitoron aktivitetet e OJQ-ve për të konstatuar sa e respektojnë statutin e tyre si dhe ligjet tjera dhe bën rekomandime për përmirësimin e tyre, bashkëpunon me institucione të rëndësishme dhe merr vendime për regjistrimin e OJQ-së, dhënien apo pezullimin e Statusit për Përfitim Publik dhe çregjistrimin e OJQ-ve.<sup>73</sup>

### **Funksionaliteti dhe bashkëpunimi me trupat tjerë institucional**

Aktualisht, departamenti ka 11 punojnës që të gjithë me ngritje të lartë profesionale si dhe me përvojë shumëvjeqare në këtë departament. Zyrtarisht, njëri prej tyre shërben për ndërlidhje me OJQ, ndonëse sipas drejtorit aktual të departamentit *'secili prej tyre kryen në njëfarë mënyre ndërlidhje me OShC-të në baza ditore, takime informative etj.'*<sup>74</sup> Në anën tjetër, përfaqësuesit e shoqërisë civile e thonë të kundërtën, sipas të cilëve për shkak të mungesës së përvojës paraprake të stafit të Departamentit me sektorin e OJQ-ve, ata nuk kanë njohuritë e duhura se si të bashkëpunohet me OJQ ose me institucione tjera të rëndësishme publike.

Të gjeturat e raportit poashtu rezultojnë se Departamenti për OJQ duket se nuk ka personel të përkushtuar që do të mirrej me aspektin e ndërlidhjes në kuadër të profilit të punës të departamentit. Është më se e qartë se ka nevojë për ndërlidhje edhe me zyrat e tjera qeveritare, veçanërisht Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), ose Doganat e Kosovës (DK), dhe të shkëmbejë informacionet mbi numrin e OJQ-ve të regjistruara, të dhënat më të reja mbi Statusin e Përfitimit Publik etj. Megjithatë, këto lidhje deri më tani janë bërë në mënyrë ad-hoc, pasi nuk ka staf të duhur që të punojnë në këtë drejtim.<sup>75</sup>

Për shembull, ekziston bashkëpunimi me ATK-në, edhe pse jo i rregullt dhe jo i institucionalizuar. Departamenti për OJQ tenton të kontaktoj këtë të fundit zakonisht për çështjet që lidhen me procedurat për marrjen e numrit fiskal, ri-përtëritjes së statusit të përfituesit publik, ose për të kontrolluar nëse OJQ-të kanë kryer me sukses detyrimet e tyre tatimore. Duhet theksuar se ATK-ja më shpesh komunikon me Departamentin për OJQ, në lidhje me organizatat e caktuara që janë të regjistruara si OJQ, të tilla si institucionet mikro-financiare, ose institucionet private të arsimit. Kjo ndodh kryesisht për shkak të të hyrave relativisht të mëdha në këto organizata.<sup>76</sup>

Nga ana tjetër, bashkëpunimi me Autoritetin Doganor duket se ndodh vetëm në rast nevoje. Kjo është e vërtetë veçanërisht kur Departamenti i OJQ-ve ka nevojë për të vërtetuar vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e statusit të përfituesit publik të OJQ-ve. Përveç kësaj, nuk duket se ka një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të institucionalizuar midis këtyre dy zyrave.<sup>77</sup>

---

<sup>73</sup> Departamenti i OJQ-ve, <http://map.rks-gov.net/sq/Page.aspx?id=18>

<sup>74</sup> Intervistë me Bajram Kosumi, DRNOJQ-MAP, 8.07.2011

<sup>75</sup> Anketë me stafin e Departamentit për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ, Prishtinë, 12 Maj 2010 (i bërë për CIVICUS Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë)

<sup>76</sup> Anketë me stafin e Administratës Tatimore, Prishtinë, 23 prill 2010 (i bërë për CIVICUS Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë)

<sup>77</sup> Anketë me stafin e Autoritetit Doganor, Prishtinë, 11 maj 2010 (i bërë për CIVICUS Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë)

---

Kur bëhet fjalë për bashkëpunim me zyrat e tjera në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, Departamenti i OJQ-ve këshillohet kryesisht me Departamentin Ligjor. Kemi parë një rritje të këtij bashkëpunimi, për shembull, në vitin 2010 gjatë procesit të ndryshimit të ligjit për OJQ, ku Departamenti Ligjor ka marrë një rol udhëheqës në grupin punues qeveritar.

Rishikimi Funkcional dhe Organizimi Institucional i Ministrive (FRIDOM), miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2009, ka gjetur shumë boshllëqe në punën e Departamentit për OJQ. Rezultatet e tyre tregojnë se departamenti anon në mënyrë të qartë drejt rolit që ka për regjistrimin ose çregjistrimin e organizatave. Megjithatë, funksioni i ndërlidhjes dhe monitorimit janë neglizhuar ose në fakt mund të kryhen nga departamentet ose institucionet tjera qeveritare. Rekomandimi i raportit FRIDOM është se ky departament duhet të shpërbëhet, dhe funksionet e tij të shpërndahen në ministritë tjera.<sup>78</sup>

Ka sigurisht një logjikë të këtyre rekomandimeve, si dhe zbatimi i tyre sigurisht do të përmirësonte efikasitetin për shërbimet e OJQ-ve. Megjithatë, rekomandimet e tilla drastike mund të kenë kuptim dhe mund të jenë të zbatueshme në qoftë se do të bëhej një shqyrtim gjithëpërfshirës i të gjitha ministrive të prekura dhe bazuar në një politikë gjithëpërfshirëse qeveritare për bashkëpunimin me shoqërinë civile. Fakti që Ministria e Administratës Publike nuk ka marrë në konsideratë rekomandimin e FRIDOM-it për shpërbërjen e Departamentit të OJQ-ve, vërteton se ende nuk ka vullnet për ndryshime të tilla të përgjithshme.

Përveç kësaj, çështje sfiduese për këtë departament mbetet bashkëpunimi i mirëfilltë me organet e rendit dhe sundimit të ligjit, veçanarisht në rastin kur nga departamenti identifikohen veprime joligjore të bëra nga OShC-të, të cilat mund të vërehen në raportet financiare të OJQ-ve për departamentin. Edhe pse në shumë konferenca përfaqësuesit e Departamentit të OJQ-ve tregojnë për raste abuzive të OJQ-ve të caktuara, ata nuk përcjellin asnjë informacion për raste të tilla, tek ndonjë organ përgjegjës, përveç tek Administrata Tatimore dhe Doganat.

### **Bashkëpunimi me shoqërinë civile respektivisht OShC-të**

Departamenti i OJQ-ve shërben si pikë kryesore kontakti për OJQ-të, për tu regjistruar dhe të paktën në teori, për t'u ndërlidhur me autoritetet qeveritare. Ligji për Lirinë e Asocimit në OJQ (gjithashtu i njohur si Ligji për OJQ), i cili ka kaluar dhe ka hyrë në fuqi në Shkurt 2009, rregullon funksionimin e këtij sektori dhe shërben si bazë ligjore për funksionimin e këtij organi. Edhe pse ky ligj është në proces të ndryshimit, në draftin e miratuar nga Qeveria në Korrik 2011, nuk janë paraparë ndryshime të mëdha për rolin dhe kompetencat e Departamentit të OJQ-ve.

Sipas Hulumtimit të Popullësisë të Indeksit të Shoqërisë Civile për Kosovë, vetëm 16.2% e OJQ-ve kanë kontakte të rregullta me këtë departament (DRNOJO), ndërsa 49.5% e OJQ-ve ka vetëm kontakte të rastit me këtë departament. Kur janë pyetur për qëllimet e këtyre kontakteve, 81,8% e OJQ-ve janë deklaruar se këto kontakte janë vetëm për qëllime zyrtare (regjistrimi, dorëzimi i raporteve vjetore

---

<sup>78</sup> <http://www.fridomks.org/media/101e%20MPS.pdf>

---

etj), ndërsa vetëm 5.7% e kontakteve në mes të OJQ-ve dhe këtij departamentit janë iniciuar nga Departamenti.<sup>79</sup> Këto shifra, rikonfirmojnë se Departamenti i OJQ-ve është kryesisht i përqendruar në regjistrimin e OJQ-ve dhe ka shumë pak aktivitete ndërlidhse me OJQ.

Aktualisht, më shumë se 6260 OJQ janë të regjistruar në këtë departament. Si përgjigje në pyetjen tonë në lidhje me nivelin e ndërveprimit me OJQ, Departamenti për OJQ konfirmoi se çdo muaj regjistorhen nga 20-25 OJQ të reja, ndërsa vetëm gjatë Qershorit 2011, janë regjistruar 60 OJQ të reja. Nga numri i përgjithshëm i OJQ-ve të regjistruara, 245 kanë statusin e përfituesit publik. Kur flitet për raportim, gjatë vitit 2009, 212 OJQ kanë paraqitur raportet e tyre financiare. Prej këtij numri, 132 prej tyre kanë qenë OJQ me status të përfituesit publik, ndërsa pjesa tjetër e tyre i kanë dorëzuar në mënyrë vullnetare.

